



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 143 të Ligjit Nr. 03/l-233 për mbrojtjen e natyrës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 85/2010”, e konform nenit 29 dhe 40, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M
Për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-56, të datës 15.03.2007

Neni 1

Me këtë vendim ndryshohet-plotësohet vendimit, 01-Nr-56 i datës 15.03.2007 për mbrojtjen e vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Suharekës, me qëllim të zëvendësimit të monumenteve të natyrës.

- 1.1 Monumentet e mbrojtura të natyrës të cekur në pikën 4. Trungjet e dushkut (Quercus sp.) në varrezat e fshatit Grejkoc, në pikën 5. Trungu i Plepit (Populus sp.) në shatin Reçan dhe pika 5. Burimi i ujit mineral në fshatin Reçan, të vendimit 01-Nr-56, të datës 15.03.2007, largohen nga lista e zonave të mbrojtura për shkak të dëmtimeve.
- 1.2 Vlerat e natyrës të evidentuar si më poshtë futen në listën e zonave të mbrojtura në territorin e Komunës së Suharekës:
 - 1.2.1 Trungu i dushkut në Suharekë me sipërfaqe prej 500m²
 - 1.2.2 Trungu i dushkut në Krushic të Poshtme (në varrezat e fshatit) me sipërfaqe prej 500m² dhe
 - 1.2.3 Trungu i dushkut në Bllacë (në varrezat e fshatit) me sipërfaqe prej 500m²

Neni 2

Ndërsa pjesët tjera kompletë të vendimit bazë me numër 01-Nr-56 i datës 15.03.2007, mbesin të pa ndryshuara.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Me datë _____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI



Duke u bazuar në nenin 9 të ligjit për mbrojtje të natyrës dhe nenin 39 të Statutit të Kuvendit të Komunës së Suharekës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 14.03.2007 mori këtë:

V E N D I M

Për mbrojtjen e vlerave të natyrës në territorin e KK Suharekë

Neni 1.

Me këtë vendim merren nën mbrojtje të vlerave të natyrës në territorin e KK Suharekë vlera këto me karakter specifik të cilat janë evidentuar nga instituti për mbrojtje të natyrës të cilat po i paraqesim më poshtë:

Emërtimi i zonës	Vendi	Shtrirja gjeografike			Kategoria që merret për mbrojtje
		Koordinata X	Koordinata Y	Lart. Mbidetare(m)	
1. Trungjet e dushkut (Quercus sp.) në varrezat e fshatit	Breshanc	0482014	4695282	442	Monument natyre (botanik) III
2. Kompleksi i trungjeve të dushkut (Quercus sp.) në varrezat e fshatit	Savrovë	0489562	4686404	499	Monument natyre (botanik) III
3. Trungu i pishës (Pinus sp.)	Delloç	0493292	4681180	813	Monument natyre (botanik) III
4. Trungjet e dushkut (Quercus sp.) në varrezat e fshatit	Grejkoc	0486437	4681890	503	Monument natyre (botanik) III
5. Trungu i Plepit (Populus sp.)	Reçan	0488769	4689347	445	Monument natyre (botanik) III
6. Burimi i ujit mineral	Reçan				Monument natyre (hidrologjik) III
7. Kompleksi i trungjeve të dushkut (Quercus sp.)	Mohlan	0469239	7492161	685	Monument natyre (botanik) III
8. Trungu i Vodhes (vojse)	Budakovë				Monument natyre (botanik) III
9. Kompleksi i trungjeve të dushkut (Quercus sp.)	Papaz				Monument natyre (botanik) III
10. Dy trungjet e bungut (Quercus sp.) në varreza të fshatit (1)	Bllacë	0487350	4696024	590	Monument natyre (botanik) III

11.	Trungu i qarrit (Quercus sp.)	Vraniq	0492547	4686691	601	Monument natyre (botanik) III
12.	Lokaliteti i bujgerit Quercus trojana	Biraqë	0488248	4691328	542	Monument natyre (botanik) III
13.	Kompleksi i trungjeve të bungut në varrezat e vjetra të fshatit	Luzhnicë	0492693	4700649	1038	Monument natyre (botanik) III
14.	Guri i Xhamisë	Luzhnicë	0492925	4700166	967	Monument natyre (gjeomorfologjik) III

Neni 2.

I lejohet Instituti të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës si institucion profesional në kuadër të Ministrisë për mjedis dhe Planifikim Hapësinor që të përkujdeset për mbrojtjen e vlerave të natyrës në territorin e KK Suharekë të parapara në këtë vendim.

Neni 3.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS - SUHAREKË

01 nr-56
Suharekë, datë: 15.03.2007

Kryetari i Kuvendit

Sali Asllanaj